



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

R R E G U L L O R E

PËR

**“SHËRBIMET RADIOAMATORE
NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

*Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1222, Datë 13.04.2010
Ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2257, Datë 23.01.2013*

Neni 1

Fusha e zbatimit

- (1) Kjo rregullore zbatohet ndaj personave fizike, shoqatave dhe institucioneve të formimit profesional që zhvillojnë aktivitet radio amator në Republikën e Shqipërisë.
- (2) Kjo rregullore zbatohet ndaj gjithë stacioneve në shërbimin amator dhe amator me satelit (me poshtë së bashku do t'ju referohemi si “shërbim amator”), me përjashtim të stacioneve të hapsirës të shërbimit amator satelitor.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo Rregullore është përgatitur në zbatim të nenit 64 - Plani i Përdorimit të Frekuencave, pika 7 dhe neni 8 pika th) e ligjit nr. 9918, dt. 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; rekomandimeve dhe Radio Rregullores Ndërkombëtare të nxjerra nga ITU dhe CEPT dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është anëtare, si dhe legjislacionin Shqiptar në fuqi.

Neni 3

Rregullat bazë të aktivitetit radioamator

- (1) Radio amator nënkupton cilindo që plotëson kushtet për kryerjen e aktivitetit radio amator.
- (2) Aktivitet radio amator nënkupton pjesëmarrjen në shërbimin radio amator nëpërmjet operimit të një stacioni radio amator (më poshtë i quajtur “stacion amator”) ose radiokomunikimi në një stacion amator (më poshtë i quajtur “komunikim”) pa interes personal, pa interes financiar, që ka për qëllim vetë-formimin, zhvillimin teknik ose shkëmbimin e informacionit profesional.
- (3) Komunikim nënkupton vendosjen e një lidhje standarde për shkëmbimin e informacionit ndërmjet dy ose më shumë stacioneve amatore ose aparateve dhënës-marrës.
- (4) Mbajtja e një stacioni amator në gjendje operimi, operimi i një stacioni amator dhe komunikimi me të (më poshtë i quajtur “operim”) është objekt i nje licencë radio amatori (më poshtë e quajtur “licencë amatori”).
- (5) Komunikimi mund të vendoset në mënyrë të pavarur nga personat që kanë një licencë amatori.
- (6) Personat që nuk zoterojnë licencë amatori, por që janë pajisur me çertifikatën e aftësisë, mund të komunikojnë në një stacion amator grupi nën mbikqyrjen e një personi që zotëron licencë amatori në përputhje me Rekomandimin T/R 61-01 të Konferencës Europiane të Administratave të Postave dhe Telekomunikacioneve (CEPT), e cila më poshtë do të përmendet si “licencë amatori e klasës CEPT”.
- (7) Personat që nuk janë pajisur me çertifikatën e aftësisë, por janë duke u përgatitur për provim, mund të komunikojnë për qëllime aftësimi nën instruktimin e drejtpërdrejtë të një personi që ka nje licencë amatori të klasës CEPT, duke përdorur shenjën e thirrjes të instruktorit ose atë të stacionit të grupit.
- (8) Grup radio amator nënkupton

- a) një shoqatë që kryen aktivitet radio amator në përputhje me aktin e themelimit të saj,
- b) një institucion të formimit profesional, kur ai cakton operatorë të kualifikuar (instruktor) në të gjithë postet e stacioneve amatore.

(9) Operator i kualifikuar nënkupton një person fizik që është i pajisur me licencë amatori të klasës CEPT të lëshuar në Shqipëri dhe që është përgjegjës për operimin dhe përdorimin e një stacioni amator në përputhje me legjislacionin e fushës dhe rregulloret në fuqi. Në rastin e një stacioni amator special që operohet nga një person fizik, i licencuari duhet të jetë operator i kualifikuar edhe përsa i takon klasës së licencës së amatorit.

Neni 4

Tipet e stacioneve amatore

(1) Stacioni amator mund të jetë:

- a) individual,
- b) stacion radio grupi, ose
- c) stacion special amator.

(2) Stacionet amatore individuale operohen nga një person fizik.

(3) Stacionet radio të grupit operohen nga një grup (komunitet) radio amator.

(4) Stacion special amator nënkupton sa më poshtë, pavarësisht në se operohet nga një individ apo një grup:

- a) përsëritës radio amator, që shërben për ritransmetim automatik të komunikimeve radio amatore brenda të njëjtit brez ose ndërmjet brezave të ndryshëm radio amator;
- b) një transmetues matjesh, i cili në përgjithësi është një stacion amator automatik (pa operator), që punon vazhdimisht në një vend vendosje të caktuar duke transmetuar informacion identifikimi në mënyrë periodike dhe në peridhat ndërmjetëse një bartëse të pamoduluar, për të studiuar dhe testuar përhapjen e valëve elektromagnetike, për të kontrolluar pajisjet e një stacioni amator, ose për të ndihmuar në një aktivitet tjetër radio amator;
- c) stacion radio amator portal (gateway), i cili është një stacion amator që shërben për interkonektimin e përsëritësve radio amatore;
- d) stacion amator që transmeton informacion për radio amatorët;
- e) stacion amator që operohet në një garë (contest) radio komunikimi (me poshtë i quajtur “stacion gare”);
- f) stacion amator i përdorur në raste festash kombëtare, përvjetore historike, përkujtime të personave të famshëm, ose ngjarje të tjera (me poshtë i quajtur “stacion amator për raste të veçanta”).

(5) Stacioni amator ose pajisja e tij qëndrore mund të jetë:

- a) pajisje radio të vendosura (futura) në treg për shitje në përputhje me standardet përkatës të pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore për komunikime elektronike, dhe/ose njohjes reciproke të konformitetit të tyre, si dhe
- b) pajisje të konstruara apo modifikuara nga ose për një radio amator.

Neni 5

Provimi për radio amator

(1) Nivelet e provimit për radio amator janë si më poshtë:

- a) niveli bazë,
- b) niveli fillestar (novice),
- c) niveli i përcaktuar në Rekomandimin CEPT T/R 61-02, për çertifikatën e aftësisë sipas provimit të harmonizuar të radio amatorit (më poshtë referuar si 'HAREC').

(2) Cilido person i moshës

- a) mbi 14 vjec ka të drejtë të japë provim për marrjen e çertifikatës së nivelit bazë,
- b) mbi 16 vjec ka të drejtë të japë provim për marrjen e çertifikatës të nivelit fillestar ose HAREC.

(3) Provimi i aftësisë së komunikimit Mors mund të zhvillohet i veçantë ose si pjesë e provimit të cilitdo nivel.

(4) Çështjet (temat) e provimit radio amator janë treguar në Lidhjen 1.

(5) Personi që i nënshtrohet provimit duhet të plotësojë të paktën 75% të kërkesave të çdo çështje për të kaluar provimin. Në fund të provimit, komisioni i provimit duhet të informojë personat që ju nënshtruan provimit për rezultatet e arritura.

(6) Personat që dështojnë vetëm në një çështje të provimit mund të hyjnë edhe një herë në provim vetëm për këtë çështje brenda vitit. Për provimin Mors nuk lejohet provim i dytë, por vetëm përsëritje e të gjithë provimit.

(7) AKEP cakton antarët e komisionit të provimit.

(8) Antarët e komisionit të provimit duhet të jenë të moshës mbi 18 vjec dhe të paktën njëri prej tyre duhet të jetë i pajisur me licencë amatori të klasës CEPT. Komisioni i provimit duhet të përbëhet nga të paktën 3 antarë, nga të cilët njëri të jetë caktuar nga shoqata e radio amatorëve shqiptarë të njohur nga IARU (International Amateur Radio Union).

Neni 6

Regjistrimi në provimin për radio amator

(1) Regjistrimi për të marrë pjesë në provimin për radio amator bëhet duke plotësuar dhe dërguar online në AKEP formularin (Lidhja 2) e plotësuar ose të dhënat e listuara në formular.

(2) AKEP përcakton datën dhe vendin ku zhvillohet provimi mbi bazën e listës të krijuar me aplikantët e regjistruar.

Neni 7

Çertifikata e aftësisë për radio amator

(1) AKEP pajis me çertifikatë sipas Lidhjes 3, 4, 5, ose 6, në varësi të klasës dhe nivelit të provimit, çdo person që kalon me sukses provimin.

(2) Provimi i nivelit fillestar (novice) është në përputhje me Raportin 32 të CEPT/ERC për çështjet e provimit për radio amator fillestar dhe çertifikatën e aftësisë të radio amatorit fillestar (novice) të lëshuar në vendet CEPT dhe jo-CEPT.

(3) Provimi i nivelit HAREC është në përputhje me Rekomandimin CEPT T/R 61-02 për çertifikatën e aftësisë të provimit të harmonizuar të radio amatorit.

(4) Çertifikata e aftësisë Mors, e vetme, nuk mund të perdoret për të kërkuar licencën e amatorit.

Neni 8

Licenca e amatorit

(1) Një stacion amator përdoret vetëm me licencën e amatorit.

(2) Licenca e amatorit mund të jetë individuale, e grupit amator, si dhe speciale.

(3) Licenca individuale e amatorit mund t'i jepet çdo personi fizik, i cili:

a) zotëron një çertifikatë aftësie për provimin e nivelit bazë të radio amatorit, të lëshuar në Shqipëri, ose

b) zotëron një çertifikatë aftësie të provimit të nivelit "CEPT Novice" ose "HAREC", ose

c) zotëron një licencë të lëshuar jashtë vendit, e cila nuk është "CEPT Novice Licence" apo "CEPT Licence".

(4) Një licencë radio për grupin mund t'i jepet vetëm një grupi të organizuar radio amatoresh.

(5) Licenca speciale e amatorit mund t'i jepet një personi që zotëron një licencë individuale të klasës CEPT të lëshuar në Shqipëri, ose një grupi amatorësh, që dëshiron të përdorë një stacion special amator.

(6) Një radio amator mund të marrë:

a) licencë të nivelit bazë (beginner), në bazë të çertifikatës së aftësisë të nivelit bazë të lëshuar në Shqipëri,

b) licencë të nivelit "CEPT Novice" në bazë të çertifikatës së aftësisë sipas provimit të nivelit fillestar (novice) apo "CEPT Novice",

c) licencë individuale amatori të klasës CEPT në bazë të çertifikatës së aftësisë sipas provimit të nivelit HAREC.

(7) Një radio amator, licenca e të cilit është lëshuar jashtë vendit tonë dhe nuk është "CEPT Novice Licence" dhe as "CEPT Licence" mund të marrë një licencë individuale amatori të nivelit CEPT Novice, që i jep të drejtë të operojë një stacion amator në vendin tonë për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj në një vit.

(8) Brezat e frekuencave dhe parametrat e stacioneve që mund të përdoren me një licencë amatori janë treguar në Lidhjen 8.

(9) Radio amatorët që zotërojnë një licencë amatori të klasës "CEPT Novice Licence" ose "CEPT Licence" të lëshuar jashtë vendit tonë mund të operojnë stacionet amatore në Shqipëri me kushtet e transmetimit të zbatueshme për licencat e amatorit të nivelit CEPT Novice ose CEPT.

(10) Një licence amatori e klasës CEPT Novice është në përputhje me Rekomandimin CEPT ECC/REC/(05)06 për licencën e radioamatorit CEPT Novice.

(11) Një licencë amatori e klasës CEPT është në përputhje me Rekomandimin CEPT T/R 61-01 për licencën e radio amatorit CEPT.

- (12) AKEP do të publikojë në faqen e tij web dhe në rast të ndonjë ndryshimi do të modifikojë
- a) përmbajtjen e Kolonës 2 në Appendix II (Tabela e përputhshmërisë ndërmjet licencës CEPT dhe licencave kombëtare të vendeve CEPT) të Rekomandimit CEPT T/R 61-01, dhe përmbajtjen e Kolonave 2 dhe 4 të Appendix IV (Tabela e përputhshmërisë ndërmjet licencave kombëtare të vendeve jo-CEPT dhe licencës CEPT, dhe të drejtat e operimit në vendet jo-CEPT, të zotëruesve të licencave të lëshuara nga administratat CEPT sipas këtij Rekomandimi) të Rekomandimit CEPT T/R 61-01,
 - b) përmbajtjen e Kolonës 2 në Appendix II (Tabela e përputhshmërisë ndërmjet licencës CEPT Novice dhe licencave kombëtare Novice, të vendeve CEPT) të Rekomandimit CEPT ECC/REC/(05)06, dhe përmbajtjen e Kolonave 2 dhe 4 në Appendix IV (Tabela e përputhshmërisë ndërmjet licencave kombëtare Novice të vendeve jo-CEPT dhe licencës CEPT Novice, dhe të drejtat e operimit në vendet jo-CEPT, të zotëruesve të licencave Novice të lëshuara nga administratat CEPT sipas këtij Rekomandimi) të Rekomandimit CEPT ECC/REC/(05)06.

Neni 9

Kërkesa për licencë amatori

- (1) Me marrjen e kërkesës online, AKEP kryen procedurën e lëshimit (dhënies) të licencës së amatorit.
- (2) Kërkesa paraqitet me formularin e plotësuar dhe dërguar online, i cili është dhënë në Lidhjen 7. Kur kërkohet një licencë speciale amatori, duhet plotësuar online formulari i kërkesës për licencë amatori nga një person fizik ose një grup radio amator dhe formulari i të dhënave të stacionit amator special.
- (3) Kërkesës online duhet t'i bashkëlidhen sa më poshtë:
- a) kur kërkohet licencë individuale amatori:
 - aa) një kopje e certificates së aftësisë, ose
 - ab) një kopje e licencës së amatorit të lëshuar jashtë vendit, e ndryshme nga identifikimi “CEPT Novice Licence” ose “CEPT Licence”;
 - b) kur kërkohet licencë amatori radio grupi:
 - ba) numri i licencës të operatorit të kualifikuar amator,
 - bb) një kopje e çertifikatës së aftësisë “HAREC” të operatorit të kualifikuar dhe licencë amatori e tipit “CEPT Licence”, në se ato nuk janë lëshuar në Shqipëri,
 - bc) emri dhe autorizimi i personit të autorizuar për të përfaqësuar grupin radio amator,
 - bd) deklaratën e operatorit të kualifikuar se ai nuk mbulon (kryen) funksionin e operatorit të kualifikuar në një stacion amator të vendosur në një pozicion tjetër;
 - c) kur kërkohet një licencë speciale amatori:
 - ca) formulari i plotësuar me të dhënat e stacionit amator me përjashtim të stacioneve të garave, apo stacioneve amatore të instaluar për orientim gjatë garave,
 - cb) opinionin i shoqatës së interesuar të radioamatorëve rreth shenjës së thirrjes, parametrave të transmetimit dhe periudhës së vlefshmërisë, me përjashtim të stacioneve amatore të instaluara për një garë radioorientimi,
 - cc) në rastin e një stacioni amator të operuar nga një grup amatorësh, një kopje e çertifikatës së aftësisë të operatorit instruktor e klasës “HAREC” dhe licenca e tipit “CEPT Licence” në rastin kur ato nuk janë lëshuar në Shqipëri,
 - cd) në rastin e një stacioni që transmeton informacion për radio amatorët, i cili operohet nga një grup radio amatorësh, deklaratë e operatorit instruktor se ai nuk kryen funksionin e instruktorit në një stacion amator në një vend vendosje tjetër,
 - ce) në rastin e stacionit amator që operohet nga një grup amatorësh, emrin dhe autorizimin e personit të autorizuar të përfaqësojë grupin si dhe NIPT-in e shoqatës dhe në mungesë të tij numrin e kodit fiskal të personit të autorizuar të firmosë në emër të grupit.

(4) AKEP mund të kërkojë paraqitjen e çertifikatës së aftësisë ose licencës së amatorit origjinale, kur ato janë lëshuar jashtë vendit tonë.

(5) AKEP pranon çertifikatën e aftësisë ose licencën e amatorit pa pasur nevojë që ato të kenë një çertifikim diplomatik nga zyra e përfaqësisë diplomatike të Shqipërisë në shtetin ku janë lëshuar këto dokumente.

(6) Licencat e tipit “CEPT Novice Licence” dhe “CEPT Licence” të lëshuara në gjuhë të ndryshme nga anglishtja do të pranohen nga AKEP vetëm të shoqëruara me kopje të çertifikuar (noterizuar) të përkthimit.

(7) AKEP do të shqyrtojë aplikimin e dërguar online dhe do të vendosë të japë Licencën brenda 7 (shtatë) ditëve nga plotësimi i formularit dhe dokumentacionit të kërkuar, sipas kërkesave të rregullores. Nëse formulari ose dokumentacioni paraqitet jo i plotë, atëherë brenda 5 (pesë) ditëve do kthehet për tu riplotësuar online. Formulari i Aplikimit për pajisjen me “Licencë radioamatori” ose regjistrim për provimin radioamator do të plotësohet në faqen web: www.akep.al.

Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryetari.

Formulari i aplikimit online nënshkruhet nga subjekti në momentin e tërheqjes së Licencës/Çertifikatës dhe i bashkëngjitet praktikës që arkivohet në AKEP së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Neni 10

Përmbajtja e licencës së amatorit

(1) Licenca e amatorit duhet të përmbajë sa më poshtë:

- a) emrin dhe mbiemrin e të licencuarit;
- b) adresen e të licencuarit (në rastin e një personi fizik vendbanimin e tij të përhershëm, në rastin e një organizate shoqërore apo institucioni trajnues zyrat e regjistruara të tyre);
- c) adresa e e-mail të të licencuarit;
- d) në rastin e një personi fizik vendin dhe datën e lindjes;
- e) në rastin e licencës së një grupi ose speciale vend vendosjen e stacionit amator (QTH);
- f) në rastin e një përsëritësi amator, transmetuesi matjesh, stacioni portal, si dhe stacioni që transmeton informacion për amatorët, parametrat e transmetimit të stacionit amator;
- g) numrin e licencës;
- h) shenjën e thirrjes të të licencuarit;
- i) në rastin e licencës individuale të amatorit, numrin e certifikatës së aftësisë në bazë të të cilës është lëshuar licenca;
- j) në rastin e një licence të lëshuar një grupi radio amatorësh, numrin e licencës së amatorit të operatorit instruktor;
- k) klasën e licencës;
- l) në se përdorimi i transmetimit telegrafik është i lejuar apo jo;
- m) periudha e vlefshmërisë së licencës;
- n) emri i autoritetit që lëshon licencën;
- o) datën e lëshimit të licencës.

(2) Në rast të ndryshimit të të dhënave të të licencuarit ose të stacionit amator, duhet kërkuar modifikimi i licencës së amatorit nga AKEP brenda 30 ditëve.

(3) Ndryshimi i vend vendosjes (QTH) të treguar në licencën e amatorit të grupit për një periudhë më të shkurtër se 60 dite nuk është objekt i modifikimit të licencës, por vend vendosja e re duhet t'i njoftohet paraprakisht AKEP.

(4) Ndryshimi i vend vendosjes (QTH) të një stacioni amator individual për një periudhë më të gjatë se 60 ditë duhet t'i njoftohet paraprakisht AKEP.

Neni 11

Zona dhe vlefshmëria e licencës së amatorit

(1) Licencat e lëshuara për stacionet individuale dhe stacionet amatore të instaluar për gara radio orientimi janë të vlefshme në të gjithë territorin e Shqipërisë; licencat e grupit radio amator dhe ato speciale janë të vlefshme vetëm në vend vendosjen e treguar në licencë, me përjashtim të stacioneve amatore të instaluar për orientim gjatë garave.

(2) Periudha e vlefshmërisë të licencës individuale të amatorit është:

a) në rastin e licencës të nivelit "beginner"

aa) 4 vjet në se aplikanti është më i vogël se 18 vjeç,

ab) 5 vjet në se aplikanti është mbi 65 vjeç;

b) 5 vjet në rastin e licencës të klasës CEPT Novice

c) 5 vjet në rastin e licencës të klasës CEPT.

(3) Licencat e amatorit për grupin janë të vlefshme për 5 vjet, por nuk mund të kalojnë vlefshmërinë e licencës individuale të instruktorit amator.

(4) Licencat speciale të amatorit janë të vlefshme për jo më shumë se 5 vjet (me përjashtim të stacioneve që përdoren për raste të veçanta), por nuk mund të kalojnë vlefshmërinë e licencës individuale të instruktorit amator. Periudha e vlefshmërisë në çdo rast do të përcaktohet nga AKEP në bazë të opinionit të shoqatës që përfaqëson vendin në IARU dhe interesit të shoqatës së interesuar të radio amatorëve.

(5) Në rastin e stacioneve që përdoren për raste të veçanta periudha e vlefshmërisë do të jetë sa periudha e zgjatjes së aktivitetit, por në asnjë rast nuk mund të kalojë një vit dhe as periudhën e vlefshmërisë të licencës individuale të instruktorit amator.

(6) I licencuari mund të kërkojë rinovimin e licencës të amatorit me anë të formularit të plotësuar të treguar në Lidhjen 7, që i dorëzohet AKEP jo më shumë se 60 ditë para përfundimit të vlefshmërisë së licencës.

Neni 12

Shenja e thirrjes

Shenja e thirrjes është një kombinim karakteresh (gërma e shifra), të renditura sipas një rregulli të caktuar, që identifikon një radioamator të licensuar, një stacion të grupit amator apo një stacion radioamator. Artikulli 25 i Radio Rregullores Ndërkombëtare, detyron shërbimin radioamator, si edhe gjithë shërbimet e tjera radio, të përdorë një sistem identifikimi të autorizuar.

Transmetimet me shenjë thirrje fals ose mashtruese janë rreptësisht të ndaluara. Arsyeja e përdorimit të shenjave të thirrjes lidhet me nevojën :

a) për të ndihmuar administratat vendase dhe të huaja të identifikojnë burimet e interferencës për shërbimet e tjera radio, në mënyrë që të merren masa për shmangien e transmetimeve jo të rregullta,

b) për të ndihmuar në administrimin dhe lëshimin e licencave .

Shenja e thirrjes transmetohet në fillim dhe në fund të çdo komunikimi dhe kur ka raste komunikimi me kohë zgjatje të madhe, ajo përsëritet çdo 10 minuta në kodin mors dhe në foni.

Çdo radioamator ka shenjen e vet të thirrjes, ajo i jepet atij bashkë me licencën e radio amatorit. Radioamatori nuk ka të drejtë të kundërshtojë shenjen e thirrjes të miratuar nga AKEP, vetëm ky organizëm mund të ndryshojë shenjen e thirrjes kur e gjykon të arsyeshme.

Neni 13 **Formati dhe dhënia e shenjës së thirrjes**

AKEP, mbështetur në Radio Rregulloren Ndërkombëtare, ka përpunuar dhe përcaktuar formatin e shenjave të thirrjes për shërbimin radioamator në Republikën e Shqipërisë.

(1) Shenja e thirrjes do të përbëhet nga jo më pak se 4 dhe jo më shumë se 7 karaktere, me përjashtim të stacioneve amatore për raste të veçanta, stacioneve të garave, si dhe stacioneve amatore të instaluar gjatë një gare për gjetje drejtimi (orientuese).

(2) Shenja e thirrjes të një stacioni që do të përdoret për raste të veçanta do të përbëhet nga jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 karaktere.

(3) Shenja e thirrjes të një stacioni gare do të përbëhet nga 4 karaktere.

(4) Çdo person fizik mund të ketë vetëm një shenje thirrje që tregohet në licencën individuale të amatorit, por mund të ketë shenja thirrje shtesë në licencat speciale të amatorit.

(5) Një grup radioamator mund të ketë një shenjë thirrje për çdo vend vendosje të një stacioni amator që tregohet në licencën amatore të grupit. Grupi amator mund të ketë shenja thirrje shtesë të treguara në licencat speciale të amatorit.

(6) Një shenjë thirrje e caktuar në një licencë individuale të pavlefshme (e skaduar) mund të caktohet përsëri për një tjetër aplikues:

- a) në rastin e licencës “beginner” dhe “CEPT Novice” mbas 2 vjetësh,
- b) në rastin e një licence të klasës CEPT mbas 3 vjetësh.

(7) Formatin e shenjës së thirrjes do të jetë si më poshtë:

a. dy karakteret e para të shenjës së thirrjes janë **“ZA”**.

b. karakteri i tretë është një shifër nga **0** deri **5**, shifër që përcaktohet nga zona në të cilin zhvillon aktivitetin e tij radioamatori. Për ke të qëllim, territori i Shqipërisë është ndarë në 5 zona gjeografike dhe secilës zonë i është caktuar një shifër. Në këtë mënyrë, tre karakteret e para të shenjës së thirrjes sipas zonave do të jenë :

- për radioamatorët, banues në zonën e parë ku përfshihen rrethet : Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnjë, Peqin, Elbasan, Librazhd, **ZA1..** .
- për radioamatorët, banues në zonën e dytë ku përfshihen rrethet : Fier, Berat, Gramsh, Skrapar, Pogradec, Korçë, Bilisht, **ZA2..** .
- për radioamatorët , banues në zonën e tretë ku përfshihen rrethet : Vlorë, Tepelenë, Gjirokastrë, Delvinë, Sarandë, Përmet, Kolonjë, **ZA3..** .
- për radioamatorët, banues në zonën e katërt ku përfshihen rrethet : Krujë, Lezhë, Kurbin, Mirditë, Mat, Bulqizë, Peshkopi, **ZA4..** .
- për radioamatorët, banues në zonën e pestë ku përfshihen rrethet: Shkoder, Malsi e Madhe, Pukë, Tropojë, Has, Kukës, **ZA5..** .

- për ishullin e Sazanit jepet shenje thirrje e veçantë dhe tre karakteret e para janë **ZA0..** .

c. Më tej shenja e thirrjes kompletohet me një ose dy karaktere të tjera (gërma, ose kombinime gërma dhe shifra) p.sh. **ZA1A2, ZA3BT** etj.

(8) Radioamatori i shton shenjës së thirrjes :

a) karakterin **“/M”** dhe në foni fjalën “mobile”, kur përdor një stacion të lëvizshëm të instaluar në makinë.

b) karakteret **“/MM”** dhe në foni fjalet “maritime mobile” kur përdor një stacion nga bordi i një anije në lundrim.

c) karakteret **“/AM”** dhe në foni fjalët “aeronautical mobile” kur përdor një stacion në një avion transporti.

d) karakteret **“/A”** dhe fjalët “barre A” ose “stroke A” kur përdor një stacion radio-amator tjetër nga ai i shënuar në licencë dhe për kohe relativisht të gjatë.

e) karakteret **“/P”** dhe në foni fjalën “portable” kur përdor një stacion portativ ose kur përdor përkohësisht stacionin e tij në një vend tjetër të ndryshëm nga ai i shënuar në licencë.

f) karakteret **“/ QRP”** kur përdor stacion me fuqi deri 5 Ëat.

Kur radioamatori nuk ka stacion të tijin, por shfrytëzon një stacion tjetër, ai përdor shenjën e thirrjes së stacionit në përdorim duke i shtuar asaj edhe shenjën e tij të thirrjes.

(9) Për radioamatorët e huaj që pajisen me licencë (leje) të përkohshme transmetimi, për të kryer aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë, shenja e thirrjes formohet nga karakteret e para kombëtare **“ZA/”** dhe më tej me shenjën personale të thirrjes së radioamatorit të huaj. Nuk lejohet dhënia e shenjave shqiptare të thirrjes për radioamatorëve të huaj.

(10) Për raste të veçanta si transmetime nga ishujt, aktivitete në grup, gara apo takime radioamatorësh me karakter kombëtar apo ndërkombëtar, etj., AKEP jep shenjë thirrje të veçantë edhe për radioamatorët apo grupet amatore Shqiptare. Për çdo rast, kërkesa për shenjë thirrje të veçantë bëhet me shkrim. Shenja e thirrjes e veçantë jepet për periudha shumë të shkurta kohore. Ajo është e vlefshme vetëm për periudhën e zgjatjes së aktivitetit për të cilin është dhënë.

Neni 14 Regjistrimi

(1) AKEP do të krijojë dhe ruajë një regjistër me të dhënat e furnizuara në formularin e regjistrimit për provimin e radio amatorëve, kërkesën për licencë radio amatori, çertifikatën e aftësisë dhe licencën e amatorit.

(2) AKEP do të ruajë në një regjistër të shenjave të thirrjes, i cili do të përfshijë shenjën e thirrjes të të licencuarit, emrin dhe adresën, numrin, periudhën e vlefshmërisë dhe klasën e licencës së amatorit, si dhe informacionin që tregon kur amatori ka kaluar edhe provimin Mors.

(3) AKEP do të publikojë listën e shenjave të thirrjes në faqen e tij web dhe do të përditësojë atë çdo 6 muaj. Në se një radio amator nuk jep miratim për publikimin e të dhenave të tij personale, lista do të tregojë vetëm emrin në vend të emrit të plotë dhe emrin e qytetit ku banon në vend të adresës së plotë.

Neni 15

Komunikimi

- (1) Cdo radio amator mund të përdorë vetëm shenjën e thirrjes që është shënuar në licencën e amatorit individuale, të komunitetit, apo atëe speciale.
- (2) Radio amatori duhet të transmetojë shenjën e tij të thirrjes në fillim dhe në përfundim të cdo lidhje, gjatë komunikimit mbas të paktën tre periudhash transmetimi dhe marrje, gjatë tentativave të lidhjes të pakten cdo 10 minuta, si dhe sa herë i kërkohet nga një amator tjetër ose nga autoriteti rregullator.
- (3) Radio amatorët mund të komunikojnë vetëm me njeri tjetrin. Përrjashtim bëjnë vetëm situatat e krizës ose emergjencave kur radio amatori do të transmetojë infomacion që lidhet me ndihmën për palë të treta.
- (4) Komunikimi ndërmjet radio amatorëve duhet të jetë në një gjuhë publikisht të kuptueshme. Gjuhë publikisht e kuptueshme nënkupton çdo gjuhë të folur, kodet dhe shkurtime të përdorura nga radio amatorët dhe shkurtime të radio telekomunikacioneve të pranuar në shkallë ndërkombëtare.
- (5) Gjatë komunikimit radio amatorët mund të diskutojnë tema që lidhen me aktivitetin e tyre radio amator, përpjekjet dhe aftësimin e mëtejshëm.
- (6) Gjatë komunikimit ndalohet sa më poshtë:
 - a) komunikimi i informacionit dhe të dhënave me karakter industrial, financiar dhe komercial;
 - b) përdorimi i rrjetit të komunikimeve elektronike që nuk është destinuar për shërbimin radio amator;
 - c) transmetim i programeve;
 - d) transmetim i shenjave fallco apo mashtruese;
 - e) aplikim i një metode që ka për qëllim të fshehtë informacionin;
 - f) transmetim i sinjalit pa identifikim;
 - g) transmetim i frekuencës bartëse të pamodular për një periudhe mëe të gjatë se 2 minuta, me përjashtim të transmetuesit radio amator që perdoret për matje.

Neni 16

Dokumentet e stacionit

- (1) Në cdo stacion radio amator duhet të ruhen këto dokumente gjatë komunikimit:
 - a) licenca e amatorit;
 - b) ditari stacionit;
 - c) specifikat teknike dhe bllok diagrama e stacionit amator, si dhe skema elektrike në rastin kur pajijet janë të ndërtuara nga vetë amatori.
- (2) Në rastin e stacioneve amatore që operohen me një licence grupi ose speciale, përveç dokumenteve të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, në stacion duhet të ruhet edhe lista e personave që kryejnë aktivitet radio amator tek ky stacion.
- (3) Ndryshe nga dispozitat e paragrafeve (1) dhe (2) të mësipërm:

- a) në rastin e një stacioni amator të lëvizshëm dhe komunikimit nga një vendvendosje e ndryshme nga ajo e shënuar në licencën e amatorit, përveç licencës duhet mbajtur me vehte edhe letër njoftimi personal;
- b) në rastin e një stacioni amator që operohet pa personel, dokumentet duhet të ruhen në adresën e të licencuarit.

Neni 17

Ditari i komunikimeve

- (1) Radio amatori duhet të krijojë një ditar të komunikimeve dhe ta ruajë atë për të paktën 5 vjet mbas shënimit të fundit. Ditari i komunikimeve duhet të tregojë, për çdo lidhje, të paktën të dhënat e mëposhtme:
 - a) datën;
 - b) fillimin e komunikimit (sipas kohës universale të koordinuar UTC);
 - c) shenjën e thirrjes të stacionit me të cilin është lidhur;
 - d) frekuencën, klasën e transmetimit;
 - e) parametrat e kualitetit të komunikimit (R S T).
- (2) Kur përdoret përsëritës, mjafton të shënohet në ditar ky fakt, si dhe koha e fillimit dhe mbarimit të komunikimit nëpërmjet përsëritësit.
- (3) Në stacionet amatore që kryejnë komunikime të lëvizshme dhe në stacionet amatore speciale nuk është e nevojshme të mbahet ditar i komunikimeve. Bëjnë përjashtim stacionet amatore që përdoren në gara dhe ato për raste të vecanta.

Neni 18

Kufijtë e transmetimit

- (1) Radio amatorët duhet të zbatojnë dispozitat e rregullave të vendosura nga Ministria e Mjedisit për kufijtë e ekspozimit të popullsisë ndaj fushave elektrike, magnetike dhe elektromagnetike në diapazonin e frekuencave 0 Hz – 300 GHz.
- (2) Gjatë komunikimit duhen bërë përpjekje për të siguruar që fuqia e rrezatuar dhe gjerësia e brezit të mos kalojë ato nivele që janë të nevojshme për sigurimin e një komunikimi të qendrushëm.
- (3) Venia në punë, riparimet, si dhe provat që kryhen me pajisjet transmetuese dhe marrëse të stacionit amator, duhet të kryhen me përdorimin e antenës artificiale në dalje të pajisjes.

Neni 19

Inspektimi

- (1) AKEP inspekton aktivitetin e stacioneve amatore të radio amatorëve.
- (2) Periudha e kontrollit të parametrave teknike gjatë inspektimit nga AKEP nuk duhet të zgjasë më shumë se 10 ditë pune.
- (3) Për skjarimin e çështjeve që lidhen me pajtueshmerinë elektromagnetike dhe përdorimin e frekuencave, AKEP mund të kërkojë nga radioamatori që gjatë periudhës së inspektimit të shënojë

në ditarin e stacionit të dhënat që lidhen me operimin e stacionit amator sipas kërkesave që përcaktohen nga AKEP dhe t'ja japë këto të dhëna inspektorëve.

(4) AKEP mund të identifikojë stacionin amator nëpërmjet marrjes dhe regjistrimit të sinjaleve të transmetuar dhe inspektimit të parametrave të tij.

(5) Për përdorim ilegal të stacioneve amatore dhe shkelje të parashikuara nga ligji nr. 9918, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, do të zbatohen masat administrative përkatëse.

Neni 20

Heqja e licencës së amatorit

(1) Në se AKEP merr informacion se një i licencuar nuk ka zbatuar detyrimet e parashikuara nga pikat (3) dhe (4) të nenit 10 të kësaj rregullore, ai i dërgon një kujtesë të licensuarit për të kryer njoftimin e munguar. Në se i licencuari nuk dërgon informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, AKEP i heq licencën me anë të një vendimi.

(2) AKEP heq licencën e amatorit edhe në rast se:

a) një gjë e tillë është kërkuar nga një vendim përfundimtar i gjykatës,

b) kundër tij është marrë një vendim përfundimtar për kryerje të shkeljeve që lidhen me aktivitetin e radio amatorit për të tretën here.

Neni 21

Dispozita përfundimtare

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi më 13.04.2010 dhe ç'fuqizon çdo rregull apo rregullore të zbatuar nga AKEP para kësaj date për shërbimin radio amator.

(2) Certifikatat e amatorëve të lëshuara para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore do të jenë të vlefshme deri në pajisjen e tyre me çertifikatë sipas kësaj Rregullore, por jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes së saj në fuqi.

(3) Me kërkesë, AKEP do të japë një çertifikatë aftësie ose kopje të çertifikatës së aftësisë në përputhje këtë Rregullore në bazë të provimit për radio amator të kaluar me sukses para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore.

(4) Kur kërkohet modifikimi ose rinovimi i një licence individuale amatori të lëshuar para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, i licencuari mund të ruajë shenjën e thirrjes që i ishte caktuar në licencën e tij të mëparshme. Neqoftese në kohën e paraqitjes së kërkesës i licencuari ka më tepër se një shenjë thirrje në bazë të më shumë se një licence individuale të radio amatorit, AKEP do të heqë gjithë licencat individuale të të licensuarit dhe do të japë një licencë të re individuale radio amatori. I licencuari mund të tregojë në kërkesën e tij së cilën shenjë thirrje dëshiron të mbajë.

Shënim:

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 947, datë 28.12.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 599, datë 23.7.2010", ka miratuar ndryshimin sa i takon pagesës së parashikuar sipas paragrafit 2.5 Tabela 9. Kjo pagesë nuk do të aplikohet për licencat e përkohshme të radio amatorëve të huaj me afat deri në tre muaj, të cilët zotërojnë licencë të tipit CEPT.

Çështjet (temat) e provimit radio amator

Sipas Rekomandimit CEPT T/R 61-02 dhe Raportit ERC Nr.32.

Temat e provimit mbulojnë çështjet vijuese, të cilat janë të rëndësishme për komunikimin, përpjekjet për lidhje dhe provat me stacionet amatore. Kjo përfshin skemat elektrike dhe diagramat përkatëse. Pyetjet mund t'ju referohen qarqeve të integruar dhe qarqeve që përbëhen nga komponente diskrete.

Përveç njohurive për temat teorike, kandidati duhet të kalojë një provim praktike, që ka të bëjë me aftësitë e tij për të komunikuar.

Njohuritë për temat që janë detyruesë për nivelin përkatës të provimit, tregohen në tabelen vijuese me shenjën X.

Shenjat për nivelet përkatës të provimit, të përdorura në kokat e tabelave:

E = Niveli Entry (baze)

A= Niveli Novice (fillestar)

B= Niveli HAREC

Njohuritë e kërkuara për temat në nivelet e dhëna të provimeve:

Niveli Entry (baze): aftësi teorike të nivelit bazë, njohuri bazë mbi elektricitetin dhe teknologjitë radio. Aftësi për të ngritur (përgatitur për punë) dhe kontrolluar pajisjet e një stacioni amator.

Niveli Novice (fillestar): përveç aftësive teorike bazë, njohuri praktike mbi pajisjet. Njohuri për komponentët kryesore të stacioneve amatore, qëllimit të tyre, si dhe kërkesa për njohuri të strukturës në nivel të bllok diagramave.

HAREC: përveç njohurive të kërkuara për nivelin Novice, aftësi për të njohur dhe analizuar qarqet, përcaktimin e parametrave të tyre teknike dhe interkoneksionit, prezantim të operimit të tyre. Njohuri të pjesëve kryesore të stacionit në nivel të diagrames të qarqeve.

Provimi për aftësi në Mors nuk lidhet me nivelet e mësipërme të provimeve.

Kërkesa të përgjithshme:

	E	A	B
1. Njesitë e matjes të sasive dhe shumfishët e nënfishet e tyre që përdoren më tepër	X	X	X
2. Përdorimi i simboleve komplekse	X	X	X
3. Tërma matematike dhe operimi me ato:			
veprimet bazë arithmetike (mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim)	X	X	X
fraksionet	X	X	X
fuqitë e dhjetës, sasi të eksponenciale, logaritmet			X
ngritja në fuqi të dytë, nxjerrja e rrënjes katrore		X	X
vlerat inverse			X
interpretim i diagramave lineare dhe jolineare			X
sistemi i numrave binare			X
4. Zbatimi dhe modifikimi i formulave			X

I. Çështjet teknike:

1. Elektriciteti, elektromagnetizmi dhe teoria radio	E	A	B
1.1. Përcjellshmëria:			
përcjellesi, gjysëm-përçuesit, izoluesit	X	X	X
rryma, tensioni, rezistenca	X	X	X
njesitë amper, volt dhe ohm	X	X	X
Ligji Ohmit	X	X	X
Ligjet Kirchhoffit			X
fuqia elektrike		X	X
njesitë e fuqisë	X	X	X
energja elektrike			X
kapaciteti i baterive (amper-orë)			X
1.2. Burimet e ushqimit:			
bateritë dhe njesitë e fuqisë së ushqimit	X	X	X
burimi i fuqisë, forca electromotore, rryma e qarkut të shkurtër, rezistenca e brendshme, tensioni i daljes		X	X
lidhja seri dhe paralel e burimeve të ushqimit			X
1.3. Fusha elektrike:			
intensiteti i fushës elektrike			X
njësia e fushës elektrike (volt / metër)			X
mbrojtja nga fushat elektrike			X
1.4. Fusha magnetike:			
fusha magnetike e gjeneruar rreth përcjellësit të rrymës			X
mbrojtja nga fushat magnetike			X
1.5. Fusha el.-magnetike:			
valet radio si valë elektromagnetike	X	X	X
marrëdhëniet ndërmjet shpejtësisë së përhapjes, frekuencës dhe gjatësisë së valës	X	X	X
Polarizimi		X	X
1.6. Sinjalet sinusoidale:			
prezantimi grafik në funksion të kohës	X	X	X
vlera e castit, amplituda, vlera efektive, vlera mesatare			X
perioda, koha periodike		X	X
frekuenca	X	X	X
njesia e frekuencës	X	X	X
faza, diferenca e fazës			X
1.7. Sinjalet jo sinusoidale:			
sinjalet audio frekuence		X	X
sinjalet dixhitale, sinjale kuadratike		X	X
prezantim grafik në funksion të kohës		X	X
komponentja bazë e tensionit, vala bazë, komponentet e harmonikave me të larta			X

zhurmat (zhurma termike e marrësit, zhurmat e brezit, densiteti i zhurmës, fuqia e zhurmës në brezin e dobishëm të marrësit)			X
1.8. Sinjalet e modular:			
tipet e modulimit, forcimet, dobësimet	X	X	X
vala mbartëse e pamodular (CW)	X	X	X
modulimi amplitude (AM)	X	X	X
modulimi në fazë, modulimi në frekuence (FM) dhe modulimi amplitudë me një brez anësor (SSB)	X	X	X
thellesia e modulimit dhe indeksi i modulimit			X
bartësja, brezat anësore, gjerësia e brezit		X	X
format e valës të sinjaleve CW, AM, SSB dhe FM			X
spektri i sinjaleve CW, AM dhe SSB			X
tipet e modulimit dixhital: FSK, BPSK, QPSK, QAM		X	X
modulimi dixhital: bit rate, karakter rate (Baude rate) and gjerësia e brezit			X
kontrolli i dendësisë ciklike (cyclical redundancy check (CRC)), ritransmetimi, korrektimi i gabimit (forward error correction (FEC))			X
1.9. Fuqia dhe energjia:			
fuqia e sinjaleve sinusoidale	X	X	X
raportet e fuqisë të vlerave në dB vijuese: 0 dB, 3 dB, 6 dB, 10 dB, 20 dB (për të dyja vlerat: pozitive dhe negative)			X
raportet e fuqisë së hyrjes dhe fuqisë së daljes në dB tek amplifikatorët tandem ose shuarësit			X
përshtatjet dhe tipet e tyre			X
marredhënia ndërmjet fuqisë së hyrjes dhe fuqisë së daljes dhe efektivitetit		X	X
fuqia mbështjellëse pik (PEP)			X
1.10. Përpunimi i sinjalit dixhital:			
modelimi dhe kuantizimi (sampling and quantisation)		X	X
frekuenca më e ulët e modelimit (loëest sampling frequency (Nyquist frequency))			X
ndërthurja (fusha kohë / fushen frekuencë, paraqitja grafike)			X
filtrimi kompensues (anti aliasing), filtrimi rivendosës			X
konvertimi analog-dixhital / dixhital-analog (ADC/DAC)			X
2. Komponentet			
	E	A	B
2.1. Rezistanca:			
koncepti i rezistencës	X	X	X
njesia rezistencës	X	X	X
kurba karakteristike rrymë-tension			X
shpërndarja e fuqisë		X	X
principi bazë i kodit të ngjyrave		X	X
lidhja në seri dhe paralel e rezistencave	X	X	X
2.2. Kapaciteti:			

koncepti i kapacitetit	X	X	X
njësia e kapacitetit	X	X	X
marrëdhënia e kapacitetit me dimensionet dhe materialin dielektrik			X
reaktanca			X
marrëdhëniet e fazës ndërmjet tensionit dhe rrymës			X
parametrat e kondensatorit, kondensatorët fiks dhe të ndryshueshëm (kondensatorët me izolues ajror, mike, qeramik, plastik dhe elektrolitik)		X	X
lidhja paralel e kondensatorëve	X	X	X
2.3. Induktiviteti:			
koeficienti i induktivitetit			X
njësia e induktivitetit	X	X	X
roli i numrit të spirave, diametrit, gjatësisë dhe materialit të bërthamës në induktivitetin			X
reaktanca			X
marrëdhëniet e fazës ndërmjet tensionit dhe rrymës			X
faktori Q			X
2.4. Transformatori:			
transformatori ideal			X
marrëdhëniet ndërmjet pësjtjellimeve dhe tensionit, rrymës dhe impedencës			X
tipet e transformatorëve, zbatimet		X	X
2.5. Dioda:			
përdorimi dhe zbatimi i diodave		X	X
dioda radrizuese		X	X
dioda Zener		X	X
dioda dritë emetuese (LED)			X
dioda kapacitet (varicap)			X
tensioni, rryma dhe fuqia e kundërt			X
2.6. Tranzistori:			
tranzistori si amplifikator dhe oshilator		X	X
tranzistorët pnp and npn			X
faktori i amplifikimit			X
krahasimi i tranzistorit me efekt fushe (kanal -n dhe -p, j-FET) dhe tranzistorit bipolar			X
rezistenca ndërmjet portës dhe burimit			X
marrëdhënia ndërmjet rrymës dhe tensionit të rrjedhjes			X
tranzistori me qark me emiter, bazë, kolektor të përbashkët: impedenca e hyrjes dhe daljes të qarqeve, metodat e polarizimit			X
2.7. Të tjera:			
pajisjet e thjeshta termike, llampat elektronike			X
tensioni dhe impedenca në statet e fuqisë së lartë me llampa elektronike, transformimi i impedencës			X

qarqet e integruar të thjeshtë (dukë përfshirë amplifikatorët operacionale)			X
marredhëniet termike në qarqet e thjeshtë			X
3. Qarqet:	E	A	B
3.1. Kombinimi i komponentëve:			
lidhja seri dhe paralel e rezistencave, kondensatorëve, bobinave, diodave dhe transformatorëve		X	X
rryma dhe tensioni në qarqet e mësipërm			X
performanca në frekuencë të lartë e rezistencës, kondensatorit dhe bobinës jo ideale			X
3.2. Qarqet dhe filtrat e akordueshëm:			
karakteristika e impedencës dhe frekuencës të qarqeve rezonues dhe antirezonues		X	X
frekuenca e rezonancës		X	X
faktori Q i qarqeve oshilues të akordueshëm			X
gjerësia e brezit		X	X
filtrat e brezit		X	X
filtrat me brez të ngushtë, të gjerë, me brez kalimi dhe brez bllokimi të formuar nga komponentet pasive			X
karakteristika e frekuencës të filtrave			X
filtri Pi dhe T			X
filtri kuarc kristal, kuarc			X
efektet e komponentëve jo-ideale			X
filtrat dixhitale (shih Seksionin 1.10 dhe 3.8)			X
3.3. Njësia e burimit të ushqimit:			
qarqet radrizues gjysem-valë dhe valë e plotë, radrizuesit urë		X	X
qarqet zbutës (smoothing)		X	X
qarqet stabilizues të ushqyesve të fuqisë me tension të ulët			X
njësitë ushqyese të fuqisë çelës, ndarësit, EMC			X
3.4. Amplifikatori:			
amplifikatorët e frekuencës së ulët		X	X
amplifikatorët e frekuencës së lartë		X	X
faktori i amplifikimit, kontrolli i amplifikimit			X
karakteristika amplitude-frekuencë dhe gjerësia e brezit			X
amplifikatorët e klasës A, AB, B and C		X	X
shtrembërimet jo-lineare të amplifikatorëve, lodhja apo mbingarkimi (overdrive)			X
3.5. Detektori:			
detektori AM (detektori i mbeshjtjellëses)		X	X
detektori me diode	X	X	X
detektori produktit dhe oshilatori me rrahje frekuence (BFO)		X	X
detektori FM		X	X

3.6. Oshilatori:			
ciftimi i kundërt (gjenerimet e qëllimshme dhe të paqëllimshme)			X
faktorët që influencojnë frekuencën dhe kushtet e gjenerimit të qëndrueshëm			X
oshilatorët LC		X	X
oshilatorët me kristal, oshilatorët e harmonikave			X
oshilatori me tension të kontrolluar (VCO)			X
zhurma e fazës			X
3.7. Laku i kontrollit të fazës (Phase-locked loop (PLL)):			
laku i kontrollit, qarqet krahasues			X
sinteza e frekuencës me shkallëzues të programueshem në lakun e çiftimit të kundërt			X
3.8. Sistemet dhe sinjalet me kohë diskrete:			
rregullimi i filtrave me zgjatje të kufizuar të impulsit (FIR) dhe zgjatje të pakufizuar të impulsit (IIR)			X
